



REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA GRAMSH

LEJE NDËRTIMI

Nr.1, datë 03.03.2017
PER OBJEKTIN
“RIKONSTRUKSION DHE SHTESE KATI PER BAR-KAFE”

Në mbështetje të neneve 27, 29 dhe 39 të ligjit nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, neneve 11, 14, 15, 16, 22 dhe 23 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, dhe pas shqyrtimit të kërkesës nr.392 Prot., datë 06/01/2017, për leje ndërtimi për objektin “RIKONSTRUKSION DHE SHTESE KATI PER BAR-KAFE”, në adresën Gramsh, lagja “Sporti”, paraqitur nga zhvilluesi Shaqe Lena, dhe dokumentacionit shoqërues të kërkesës si vijon:

- Projekti dhe relacioni arkitektonik;
- Projekti dhe relacioni konstruktiv;
- Preventivi i punimeve;
- Plani i vendosjes së ndërtimit mbi fragmentin e azhornuar të hartës së parcelës;
- Grafiku i punimeve;
- Projekti dhe relacioni i mbrojtës nga zjarri;
- Projekti dhe relacioni elektrik;
- Projekti dhe relacioni hidrosanitar;
- Formati i aplikimit, i nënshkruar elektronikisht;
- Prokure për autorizimin e aplikuesit;
- Kopje e dokumentit të pronësise;
- Kopje e licenses;
- Deklarata e projektuesit të licencuar, për përputhshmërinë e projektit me dokumentet e planifikimit dhe legjislacionin në fuqi, sipas sistemit online;

VENDOSA:

1. Lëshimin e kësaj lejeje ndërtimi për zhvilluesin Shaqe Lena, NID F76018042U, të ciles i lejohet ndërtimi i objektit “RIKONSTRUKSION DHE SHTESE KATI PER BAR-KAFE”, në pasurinë me nr. pasurie 8/90-N5, ZK 1842, në pronësi të zj. Shaqe Lena, me kufij V. Hapesire, L.8/90-N4, J. 8/90-N21, P. Hapesire, sipërfaqe 106.2 dhe adresë Gramsh, lagja "Sporti", sipas kushteve të zhvillimit që vijnë:

1. Sipërfaqja e parcelës e zënë nga ndërtimi (m ²):	146
2. Sipërfaqja totale e ndërtimit (m ²):	208
3. Lartësia maksimale e ndërtimit nga niveli zero i ndërtimit (m):	7
4. Numri i kateve mbi nivelin e tokës:	1
5. Numri i kateve nën nivelin e tokës:	1
6. Përdorimet e lejuara në objekt/objekte (funksioni):	Sherbime tregtare, administrative etj.

2. Kjo leje është e vlefshme për një periudhë **6 (gjashtë) mujore** nga data e fillimit të punimeve, referuar grafikut të punimeve.

3. Afati i fillimit të punimeve është deri në 1 (një) vit nga data e lëshimit të kësaj lejeje. Kjo leje është e pavlefshme nëse zhvilluesi nuk fillon punimet e ndërtimit brenda afatit një vjeçar pas lëshimit të saj, bazuar në nenin 40 të ligjit nr.107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar.

4. Nëse ndërtimi ka filluar pas kalimit të afatit njëvjeçar apo vijon edhe pas përfundimit të afatit të përfundimit të punimeve, punimet konsiderohen të paligjshme.

5. Në rast shkelje të kushteve të kësaj leje do të merren masa në përputhje me ligjin, deri në prishje të punimeve të kryera. Zhvilluesi, zbatuesi dhe mbikqyrësi i punimeve janë përgjegjës solidarisht në rast kryerje punimesh në shkelje të kësaj lejeje apo të ligjeve që rregullojnë veprimtarinë e ndërtimit në Republikën e Shqipërisë, bazuar në nenin 39 të ligjit nr.107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar.

6. Zhvilluesi është i detyruar që të njoftojë paraprakisht bashkinë për fillimin e punimeve si dhe të komunikojë emrat e zbatuesit, mbikqyrësit dhe kolaudatorit të punimeve, së bashku me licensat profesionale përkatëse. Në mungesë, punimet konsiderohen të paligjshme.

7. Zhvilluesi është i detyruar që, pas përfundimit të ndërtimit dhe përpara përdorimit të tij, të kërkojë nga bashkia që të lëshojë çertifikatën e përdorimit të tij.

8. Kundër kësaj lejeje, zhvilluesi mund të paraqesë ankim brenda 15 ditëve nga data e marrjes njoftim.

KRYETARI I BASHKISË

LULJETA DOLLANI

Data e miratimit të lejes:

07.03.2017